



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesuese e KD-së
Mr. Ardiana Bunjaku

Nr. Prot.: 878
Datë: 5/9/2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina, pasi shqyrtoi kërkesat me nr. prot 05/254 dt: 25.1.2018, të parashtrua nga studentët e doktoratës në FBV, programi "Shkencat e Ushqimit dhe Teknologji Ushqimore" përmes projektit TEMPUS, më qëllim të lirimit nga pagesa e semestrave të përsëritur. Në mbledhjen e mbajtur më 22. 03. 2018, mori:

V E N D I M


- I. Të gjithë studentët e nivelit të studimeve të doktoratës që studiojnë në njësit akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe të cilët ende kanë obligime me Universitetin e Prishtinës si: Ligjërata, procedura të temave në këshill e njësive e tjera deri në përfundimin e mbrojtjes së punimit të doktoratës janë të obliguar të paguajnë sipas tarifave aktuale për semestrat e përsëritur edhe pas tejkalimit të kohëzgjatjes së studimeve (4, përkatësisht 6 semestra)
- II. Përgjashtimisht nga pika I, e këtij vendimi bëjnë pjesë vetëm studentët e doktoratës që janë të atakuar me vendimin nr. prot: 3/917 dt: 27.12.2017 të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune si personel akademik me Universitetin e Prishtinës. Studentët që i takojnë kësaj kategorie, janë të obliguar që të paguajnë vetëm për mbrojtjen e temës së doktoratës.
- III. Shërbimi i studentëve të doktoratës në njësit akademike të UP-së, obligohet që të zbatoj këtë vendim.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe vlen deri në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoi kërkesën e studentëve të doktoratës në disa njësi akademike të UP-së, e konsideroi se përveç studentëve të doktoratës që janë të atakuar me vendimin me nr. prot: 3/917 dt: 27.12.2017 e që të njëjtit janë edhe në marrëdhënie të rregullt pune si staf akademik me UP-në. Të tjerët janë të obliguar të paguajnë sipas tarifave aktuale për semestrat e përsëritur për aq sa kohë marrin edhe shërbime në Universitetin e Prishtinës përkatësisht deri në mbrojtjen e temës së doktoratës, nga ajo që u thekësua më lartë KD-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Njësive akademike të UP-së,
3. Zyrës për Çështje Studenteve,
4. Komisionit të Doktoratës,
5. Zyrës për Çështje Akademike,
6. Zyrës Ligjore të UP-së .



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Ardiana Bunjaku - Kryesuese